



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:919880  
Datë: 11.03.2024  
Numri i dokumentit: 05591024

**C.nr. 2914/21**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit Q.D. nga P. të cilin e përfaqëson Mustafë Kastrati dhe Valon Kastrati, avokat nga Peja, sipas autorizimit, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Elsig”, me seli në Prishtinë, Rr. “Tringë Smajli” nr.3, me bazë juridike kompensim dëmi, vlera e kontestit 9.000 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në prezencë të autorizuarit të palës paditëse dhe në mungesë të paditurës, në seancë publike, të datës 26.02.2024, mori, ndërsa me datën 11.03.2024, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. REFUZHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit Q.D. nga P. me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “Elsig”, me seli në Prishtinë, që paditësit të ia paguaj kompensimin e dëmit jo material, në emër të fitimit të humbur për 15% për ZAP, për periudhën 27.10.2010 – 31.12.2023, shumën prej 2,9881.91 euro dhe për periudhën 01.01.2024 e deri sa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore, rentën mujore në shumë prej 60.33 euro për muaj dhe atë të paguhet çdo muaj deri me datën 05 të çdo muaji vijues në xhirrollogarinë e paditësit, ose shumën – rentën e kapitalizuar në lartësi prej 14.225,80 euro përkatësisht shumën e gjithëmbarshme për fitimin e humbur për periudhën e kaluar dhe për periudhën e ardhshme në formë të kapitalizuar prej 17.214,71 euro me 8% kamatë duke filluar prej 05.01.2024 e deri në pagesë definitive dhe të ia paguaj kompensimin e dëmit jo material në emër të shëmtimit në shkallë të mesme shumën prej 7.000,00 euro me 8% kamatë duke filluar nga data 13.01.2017 e deri në pagesë definitive si dhe shpenzimet procedurale, e të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nga marra e aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarrimit, **si e PABAZUAR.**

**II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

***Pretendimet e palëve***

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, në këtë gjykatë me datën 19.06.2017, ka parashtruar padi ndaj të paditurës Kompanisë së Sigurimeve “Elsig”, me seli në Prishtinë, me bazë juridike kompensim dëmi, vlera e kontestit 9.000 euro si dhe shpenzimet e procedurale.

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në këtë çështje, ka nxjerr aktgjykimin C.nr.../17, i datës 28.01.2019, i cili aktvendim është kthyer në rigjykim nga gjykatës e Apelit sipas aktvendimi Ac.nr.../19, i datës 06.12.2021.

Duke vepruar sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit, sipas aktvendimi Ac.nr.../19, i datës 06.12.2021, gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin gjyqësor me datën 01.06.2023.

I autorizuari i palës paditëse në shqyrtimin kryesor të datës 01.06.2023, ka deklaruar se: mbetet në tërësi pranë deklarimeve dhe deponimeve të mëparshme të dhëna në këtë çështje, po ashtu mbetet pranë precizimit të kërkesëpadisë së datës 26.11.2018, ku në paragrafin e 5 në vend të shumës 4000 euro e precizon lartësinë e kërkesës në 7000 euro ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë mbetet e pa ndryshuar. Tutje ka propozuar që në kuptim të udhëzimeve sipas aktvendimit të Gjykatës së apelit me nr. Ac.nr.../19 të datës 06.12.2021, të i zbatoj udhëzimet të i eliminoj të metat te cilat gjykata i ka konstatuar në kuptim të nenit 160 të LPK dhe në fund të marr aktgjykim meritore lidhur me këtë çështje, po ashtu gjykatat ka konstatuar se të këto lloje të kontesteve nuk janë të parapara afatet e parashkrimit e çka bie me kundërshtim me aktgjykimin e shkallës së parë, andaj mbetet me tutje pranë kërkesëpadisë së precizuar sot meqenëse në rastin konkret nuk kemi parashkrim.

I autorizuari i të paditurës ka deklaruar se: mbetem në tërësi si në përgjigjen në padi dhe të thënat në seancat e kaluara si dhe pranë parashkrimit të datës 10.12.2018 ku edhe me tutje vazhdon të konteston në tërësi padinë dhe kërkesën e saj dhe se mbetemi pranë propozimit që gjykata të hudhë padinë dhe kërkesën e saj si të parashkruar.

Gjykata, pas vlerësimit të shkresave të lëndës, ka hapur shqyrtimin gjyqësor me datën 26.06.2023.

Gjykata, shqyrtimin kryesor të datës 26.02.2024, e ka mbajtur në mungesën të paditurës, bazuar në dispozitave ligjore të LPK-së, meqenëse e njëjta përkatësisht i autorizuari i saj ishte i ftuar në mënyrë të rregulltë për shqyrtimin në fjalë, përkatësisht sipas procesverbalit të datë 13.02.2024, por e njëjta nuk ka prezantuar dhe mungesën e saj nuk e ka arsyetuar.

### *Pretendimet e palëve*

I autorizuari i palës paditëse, në seancat e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se me administrim e provave në tërësi janë vërtetuar pretendimet e paditësit, është vërtetuar legjitimiteti i të paditurës sepse automjeti që ka shkaktuar lëndimet e paditësit ka qenë i siguar pranë të paditurës, është vërtetuar baza e kërkesëpadisë dhe atë sipas aktgjykimit të kësaj Gjykate C.nr.../15, me të cilin aktgjykim paditësit i janë kompensuar të gjitha aspektet tjera të dëmit për veç aspekteve të dëmeve të përcaktuar në këtë padi dhe atë për zvogëlimin e aftësive punuese dhe shëmtimin në shkallë të mesme, përkundër faktit se këto kanë qenë të kërkuar edhe në atë procedurë dhe kanë ekzistuar ekspertizat mirëpo gjykata nuk i ka gjykuar, andaj mbesin në tërësi si në precizim e datës 24.01.2024 dhe në tërësi është vërtetuar edhe lartësia e dëmi, si në precizim në kuptim të ekspertizave mjekësore dhe financiare, ashtu që

mbesin pranë padisë me propozimin që e njëjta të aprovohet dhe obligohet e paditura të bëj kompensimin e dëmit, duke shtuar se të një gabimi teknik në fjalën përfundimtare në rreshtin e dyte në vend të fjalës automjeti duhet të jete fjala subjekti-punëdhënësi, ndërsa pjesa tjetër e fjalës përfundimtare mbetet e pa ndryshuar, ndërsa sa i përket pretendimeve nga fjala përfundimtarë e te paditurës të njëjtat nuk qëndrojnë dhe janë në kundërshtim me aktgjykimin e Apelit dhe udhëzimet e Apelit që kanë kthyer lëndën në rigjykim, sa i përket aspekteve të dëmit për ZAP dhe shëmtim e të cilat asnjëherë nuk janë gjykuar me vendim meritor përkundër kërkesave që kanë ekzistuar dhe janë kryer ekspertizat në çështjen paraprake. Po ashtu në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim që e ka vërtetuar dhe Apelit dhe pretendimet e tjera janë jo lëndore dhe irrelevantë në këtë çështje.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë të specifikuar sipas listës.

I autorizuarit i të paditurës gjatë seancave të shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare me shkrim ka deklaruar se: e kundërshton kërkesëpadinë e paditësit sepse padia e paditësit është bërë me datën 19.06.2017, ndërsa aksidenti ka ndodhur me datën 27.10.2010, nga data e aksidentit e deri në paraqitjen e kërkesëpadisë kanë kaluar shtatë vite që vërteton se kërkesat e paditësit janë parashkruar në vitin 2014 sipas dispozitës ligjore të LMD-së. Përveç kësaj, paditësit është kompensuar për forma të tjera sipas aktgjyimit të kësaj gjykate dhe se paditësit me kohë ka qenë në dijeni kush është shkaktari dhe se nuk ka ndonjë rrethane që e ka penguar të ushtroj padi edhe për këto kategori të dëmit brenda afatit ligjor. Duke qenë se paditësit ka qenë në shkollë të mesme në vitin e fundit në datën e aksidentit nga ekspertiza është vërtetuar se ai ka filluar të punoj nga muaji 11 në vitin 2011, pra kur konsiderohet se e ka kryer shkollën e mesme dhe ka vazhduar të punoj deri sa ka krijuar marrëdhënie të rregullt pune në muajin e shtatë të vitit 2015. Pra të gjitha këto prova të vërtetuar edhe me ekspertizë vërtetohet se aksidenti dhe lëndimet e pësuar nuk kanë lënë pasojë tek paditësit dhe nuk i kanë krijuar asnjë humbje dhe arsye se pse nuk ka punuar gjatë tërë kohës nga vitit 2011, kur e ka përfunduar shkollën e deri në muajin e shtatit të vitit 2015 nuk kanë qenë si pasojë e aksidentit sepse paditësit ka punuar vazhdimisht. I njëjti shton se i padituri nuk ka për detyrë të kompenzon secilin person i cili për arsye të ndryshme nuk punon, i njëjti është i obliguar vetëm për kompensim të dëmi nëse ai vjen si pasojë e aksidenti pra në rastin konkret nuk janë përmbushur kushtet ligjor për llogaritjen e fitimit të humbur si pasojë e aksidentit i cili do ti takonte paditësit po që se ai nuk do të kishte punuar asnjë dhe atë vetëm si pasojë e lëndimeve të shkaktuar nga aksidenti. Nga kontratë e punës së paditësit e që edhe sot e kësaj dite i njëjti punon me normë të plotë prej 100% prandaj në këtë rast nuk janë përmbushur dispozitat e të drejtës materiale përkatësisht nenin 172 të LMD-së dhe nuk është vërtetuar se si pasojë e aksidentit paditësit ka humbur fitimit të cilin po e realizonte para ndodhjes së aksidentit. Qëllimi i kompensimit të dëmit material është kthimin në gjendjen e mëparshme prandaj në këtë rast nuk është përmbushur asnjë kusht për njohën e të drejtës së fitimit të humbur dhe rentës në të ardhmen pasi që një veprim i tillë pra njohja e kësaj të drejtë pa u plotësuar kushtet ligjore të do të shkaktonte pasurim të pabazë të paditësit, duke propozuar që padia e paditësit të refuzohet si e pabazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

### *Vërtetimi i gjendjes faktike*

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, në shqyrtimin kryesor-publik, gjykata bëri administrimin e provave si: Leximi i shkresave të lëndës C.nr.../15 të Gjykatës Themelore në Pejë; leximi i urdhër pagesës se paraqitur nga pala e paditur lidhur me pagesën e bërë ndaj paditësit Q.D., me përshkrim pagesë e demit 0297/10, data e pagesës 26.01.2017; leximi i ekspertizës nga lëmia financiarë dhe aktuaristikës e datës 23.11.2018, e përpiluar nga eksperti Aziz Berisha, se bashku me shtojcën të bashkangjitur ekspertizës siç janë kontrata e punës, vërtetimin tatimore dhe pasqyra e trustit pensional, për paditësin Q.D.; leximi i ekspertizës e ekspertit të ortopedisë Dr., Nazmi Morina të dhënë në seancën e datës 30.10.2018; leximi i letërnjoftimit me të dhënat e paditësit Q.D.; leximi i certifikatës mbi arsimimin dhe aftësimin profesional të paditësit Q.D. e datës 30.08.2010, me numër të protokollit 01-493/4; leximi i kontratës se punës e lidhur ndërmjet subjektit Egi Grup sh.p.k si punëdhënës dhe Q.D. si punëmarrës, me datë 01.11.2010, me numër të protokollit 08/2017; leximi i kontratës se punës e lidhur me datë 01.12.2017, ndërmjet subjektit Egi Grup sh.p.k si punëdhënës dhe Q.D. si punëmarrës; leximi i pasqyrës e llogarisë të trustit pensional për Q.D., për periudhën 16.11.2003-16.11.2018, leximi i vërtetimit tatimorë në emër të Q.D., e leshur me datë 21.11.2018; leximi i certifikatës mbi arsimimin dhe aftësimin profesional të paditësit Q.D. e datës 30.08.2010, me numër të protokollit 01-498/4; leximi i ekspertizës se përpiluar nga Qefsere Restelica, eksperte nga mjekësia e punës, me datë 28.08.2023; leximi i ekspertizës se përpiluar nga eksperti Aziz Berisha, nga lëmia financiarë - aktuaristikës, me datë 05.01.2024, se bashku me shtojcat e bashkangjitura në ekspertizë të cilat janë, trusti përkatësisht pasqyra e llogarisë për paditësin; leximi i pasqyrave të trustit pensional për paditësin, për periudhën 01.01.2018-30.11.2023.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është tërësisht e pabazuar.

Përgjatë procedurës gjyqësore në këtë çështje juridike kontestimore, jo kontestues rezultoi fakti se paditësi si pasojë e aksidentit të shkaktuar me datën 27.02.2010, kishte paraqitur padi për kompensim dëmi, për të cilin ishte vendosur sipas aktgjykimit C.nr...15, i datës 06.07.2015, i lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë, fakt i cili u vërtetua po ashtu edhe nga aktgjykimi C.nr.../15, i datës 06.07.2015, në shkresat e lëndës C.nr.../15.

Po ashtu jo kontestues rezultoi edhe fakti se me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë C.nr...4/15, i datës 06.07.2015 i vërtetuar/ ndryshuar nga Gjykata e Apelit me aktvendim Ac.nr.../2015, i datës 06.12.2016 dhe aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev.nr.../2017, i datës 15.05.2017, paditësi i është njohur e drejtat për kompensimin e dëmit të shkaktuar si pasojë e aksidentit të datës 27.02.2010, përkatësisht për kategoritë si zvogëlimi i aktivitetit jetësor, për dhimbje fizike, për frikë të pësuar, për shpenzimet e procedurës, fakt ky i cili po ashtu u vërtetua

nga aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë C.nr..../15, i datës 06.07.2015, i cili aktgjykim ishte i vërtetuar/ndryshuar.

Po ashtu nuk ishte kontestues as fakti se pala e paditur kishte bërë pagesën e kompensimit të dëmit ndaj paditësit sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë C.nr..../15, i datës 06.07.2015 i vërtetuar/ ndryshuar nga Gjykata e Apelit me aktvendim Ac.nr ...1/2015, i datës 06.12.2016 dhe aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev.nr.../2017, i datës 15.05.2017, fakt i cili u vërtetua nga urdhërpagesa, me përshkrim pagesë e demit 0297/10, data e pagesës 26.01.2017.

Nga pretendimet e palëve ndërgjyqëse dhe argumentimet e tyre gjatë seancave, vështuar edhe nga faktet dhe provat, si çështje kontestuese paraqitet të jetë nëse paditësit i takon kompensimi i dëmit si dhe nëse kërkesa nga padia është përfshirë në parashkrim.

Nga provat e administruara përkatësisht nga shkresat e lëndës C.nr.../15 të Gjykatës Themelore në Pejë, gjykata gjeti se paditësit me datën 24.02.2012, kishte paraqitur padinë për kompensimin e dëmit të shkaktuar si pasojë e aksidentit të datës 27.02.2010, për kategoritë e dëmit si shpenzimet e shërimit, zvogëlimin e aktivitetit jetësor, dhimbjet fizike të pësuar, frikën e pësuar, humbjen e një viti shkollor dhe për ushqim të përforcuar dhe kujdesin e personit të terte, për të cilën kërkesë gjykata e shkallës së parë kishte vendosur sipas aktgjykimi C.nr...2/12, i datës 05.02.2013, i cili aktgjykim ishte kthyer në rigjykim nga Gjykata e Apelit me aktvendimin Ac.nr....9/2013, i datës 30.03.2015. Gjykata shkallës së parë sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit, ka nxjerre aktgjykimin C.nr.../15, i datës 06.07.2015, sipas të cilit aktgjykim është aprovuar kërkesëpadia e paditësit dhe është detyruar e paditura që të bëjë kompensimin e dëmit dhe atë për zvogëlimin e aktivitetit jetësor, për dhimbjet e pësuar fizike, për frikën e pësuar, për shpenzimet e procedurës, ndërsa pjesa tjetër mbi shumat e gjykuara ishte refuzuar për zvogëlimin e aktivitetit jetësor, për dhimbjet e pësuar fizike, për frikën e pësuar, për ushqimin e përforcuar dhe kujdesin e personit të tretë, i cili aktgjykim ishte ndryshuar dhe vërtetuar sipas aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ac.nr.../2015, i datës 06.12.2016, e i cili vendim ishte vërtetuar nga Gjykata Supreme sipas aktgjykimit Rev.nr.../2017, i datës 15.05.2017.

Nga urdhër pagesa e paraqitur nga pala e paditur lidhur me pagesën e bërë ndaj paditësit Qëndrim Dinaj, me përshkrim pagesë e demit 0297/10, data e pagesës 26.01.2017, gjykata gjeti se pala e paditur kishte përmbushur detyrimin ndaj palës paditëse, për kompensimin e dëmit, në shumën e përcaktuar sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë C.nr..../15, i datës 06.07.2015 i vërtetuar/ ndryshuar nga Gjykata e Apelit me aktvendim Ac.nr .../2015, i datës 06.12.2016 dhe aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev.nr.../2017, i datës 15.05.2017.

Nga ekspertiza nga lëmia financiarë dhe aktuaristikës e datës 23.11.2018, e përpiluar nga eksperti Aziz Berisha, se bashku me shtojcën të bashkangjitur ekspertizës siç janë kontrata e punës, vërtetimin tatimore dhe pasqyra e trustit pensional, për paditësin Q.D., ka ardhur në përfundim se paditësit si pasojë e lëndimeve të tij në aksidentit e komunikacionit të datës 27.10.2010, përpos në lloje të tjera të dëmit i takon edhe e drejta në kompensim e dëmit material fitimit të humbur përkatësisht rentës e cila arrin vlerën prej: a) Për periudhën e kaluar prej

aksidentit të datës 27.10.2010 e deri me datën 31.10.2018 kur po konsideron si datë të kryerjes së kësaj ekspertize në shumën prej 2.023.65euro, që së bashku me kamatën e llogarit sipas arritjeve mujore për pagesë e normë prej 12% vjetore prej ditës së ushrit të paditëse me 16.06.2017 e deri më tani 31.1.2018, prej 333.90, arrin në gjithsej 2,357.55 euro dhe b) për periudhën e ardhme pas 01.12.2018 (kur atij i skadon kontratës e punës tek punëdhënës i tij aktual në Egi Group Sh.P.K., atij do të i takoj e drejta në fitim të humbur prej momenti kur eventualisht ai pushohet nga puna, pra ngeltë pa punë, në formë të rentës mujore e llogaritur në propocion me invaliditetit të tij të punë prej 15% nga të ardhurat mesatare të punësuarve me përgatitje të mesme shkollore në Kosovë.

Nga ekspertiza e ekspertit të ortopedisë Dr. Nazmi Morina të dhënë në seancën e datës 30.10.2018, ka konstatuar se në bazë të ekzaminimit të paditësit në lokalet e gjykatës dhe shikimit të shkresave të lëndës, vërehet vrugë post operative e gjatë 25-30 cm dhe një hermiacion i muskulit tiabilis anterio, kështu që vlerëson si shëmtim i shkallës së mesme, duke shtuar se vruga është postoperative dhe është vrugë e operacionit të bërë për shërimin e kockës, kështu që vruga e tillë a lodhje kauzale me aksidentit.

Nga letërnjoftimi me të dhënat e paditësit Q.D., u konstatuan të dhëna personale për paditësit.

Nga certifikata mbi arsimimin dhe aftësimin profesional të paditësit Q.D. e datës 30.08.2010, me numër të protokollit 01-493/4, gjykata gjeti se paditësit është certifikuar për kryerjen e afrimit dhe aftësimin profesional në fushën ndërtimtarie dhe ka marrë thirrjen teknik i ndërtimtarisë.

Nga kontrata e punës e lidhur ndërmjet subjektit Egi Grup sh.p.k si punëdhënës dhe Q.D. si punëmarrës, me datë 01.11.2010, me numër të protokollit 08/2017, u vërtetua se paditësit kishte lidhur marrëdhënie pune me subjektin në fjalë, me pagë mujore në bruto në shumën 400 euro.

Nga kontrata e punës e lidhur me datë 01.12.2017, ndërmjet subjektit Egi Grup sh.p.k si punëdhënës dhe Q.D. si punëmarrës, gjykata gjeti se paditësit kishte krijuar marrëdhënie pune me subjektin në fjalë, i sistemuar në pozitën prej vozitësit personal, me pagë bazë në shumën prej 340 euro.

Nga pasqyra e llogarisë të trustit pensional për Q.D., për periudhën 16.11.2003-16.11.2018, gjykata gjeti se bilanci përfundimtar i trustit pensional të paditësit për këtë periudhën ishte në shumën prej 2,161,32 euro

Nga vërtetimit tatimorë në emër të Q.D., e lëshuar me datë 21.11.2018, gjykata gjeti se paditësit është i regjistruar në ATK dhe nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime të tjera.

Nga certifikata mbi arsimimin dhe aftësimin profesional të paditësit Q.D., e datës 30.08.2010, me numër të protokollit 01-498/4, gjykata gjeti se paditësit është certifikuar për kryerjen e

arsimit dhe aftësimin profesional në fushën ndërtimtaria dhe ka marrë thirrjen teknik i ndërtimtarisë.

Nga ekspertiza se përpiluar nga Qefsere Restelica, eksperte nga mjekësia e punës, me datë 28.08.2023, u konstatua se shkalla e zvogëlimit të aftësisë punuese për disa aktivitet punuese të caktuara, është në shkallën prej 15%, ku duke u bazuar në anamnezën personale, ekzaminimin fizik të kandidatit, të gjitha raportet e njëpasnjëshme të eksperteve të lëmvive përkatësisht konstaton se tek kandidati në fjalë si pasojë e aksidentit të përjetuar me datën 27.10.2010 kemi të bëjmë me një lëndim të rendë. Ekspertiza në fjalë është bazuar në tableta e zvogëlimit të aftësisë punuese të vendeve fqinje me të cilat Mjekësia e Punës shërbehet tash e një kohë të gjatë të cilat parashihen si lloj standardi për ekzaminimin e rasteve që kanë të bëjnë me zvogëlim të aftësisë punuese në profesione të ndryshme.

Nga ekspertiza e përpiluar nga eksperti Aziz Berisha, nga lëmia financiarë - aktuaristikës, me datë 05.01.2024, se bashku me shtojcat e bashkangjitura në ekspertizë të cilat janë, trusti përkatësisht pasqyra e llogarisë për paditësin Q.D., u konstatua se paditësit si pasojë e lëndimeve të tij në aksidentin e komunikacionit të datës 27.10.2010, përpos llojeve të tjera të dëmit ka pësuar edhe dëm materiale të formës së fitimit të humbur në shumat si vijon, ashtu që a) për periudhën e kaluar prej aksidentit 27.10.2010 e deri tani 31.12.2023 kur po e konsiderojmë si datë të kryerjes së kësaj ekspertize në lartësi prej 2,988.91 euro, dhe b) për periudhën e ardhshme prej 01.01.2024 e tute deri në sa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore, renta e paditësit arrin në nga 60.33 në muaj, e cila e paguar në formë të menjëhershëm – të kapitalizuar arrin në shumën prej 14.225.80 euro, pra shuma e gjithmbarshme e fitimit të humbur për periudhën e kaluar dhe për periudhën e ardhshme e paguar në formë të menjëherë të kapitalizuar arrin vlerën prej 2.988.91 + 14.225.80 euro = 17.214.21 euro.

Nga pasqyra e trustit pensional për paditësin Q.D., për periudhën 01.01.2018-30.11.2023, gjykata gjeti se bilanci i trustit pensional për paditësin për periudhën në fjalë arrin në shumën prej 4.365.59 euro.

### ***Baza Ligjore***

Gjykata, vlerëson së për rastin konkret gjejnë zbatim dispozitat ligjore të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Gazeta Zyrtare nr.30/78 (tutje LMD), ngase kemi të bëjmë me raport juridik deri sa ka qenë në fuqi ky ligj.

Neni 154 par.1 i LMD-së, parasheh se: *"Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij"*. Neni 155 i LMD-së parasheh se: *„Dëmi është pakësim i mjeteve shoqërore, respektivisht i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe parandalimi i shtimit të tyre (përfitimi i munguar), si dhe shkak i tjetrit të dhimbjës ose të frikës fizike apo psikike (demi jomaterial)"*. Neni 188 par.1 i LMD-së parasheh se: *"Në rast të vdekjes të lezionimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit kompensimi caktohet si rregull në formë të rentës në të holla për gjithë jetën ose për një kohë të caktuar"*. Neni 189 par.1 i LMD-së parasheh se: *„I dëmtuari ka të drejtë si për kompensimin e dëmit të thjeshtë*

*ashtu edhe për kompensimin e fitimit të munguar”. Neni 195 i LMD-së parasheh se: „Kush i shkakton tjetrit lezionim trupor,ose ia prish shëndetin ka për detyrë t’i kompensojë shpenzimet e mjekimit she shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit dhe Në qoftë se i lezionuari për shkak të paaftësisë së plotë ose të pjesëshme për punë e humbë fitimin,ose nevojat i janë shtuar vazhdimisht; apo mundësitë e zhvillimit të tij të mëtejshëm dhe, të përparimit janë zhdukuar ose janë pakësuar personi përgjegjës ka për detyrë ti paguajë të lezionuarit rentën e caktuar në të holla si kompensim për këtë dëm”.*

Ndërsa sipas nenit 376 par.1 dhe 2 të LMD-së parashihet se: *“Kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tre vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin dhe Sidoqoftë kjo kërkesë parashkruhet për pesë vjet nga data kur është krijuar dëmi”.* Kurse në Nenin 372 të po të njëjti ligj parashihet se: *”Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtëra (kërkesat periodike) si kur është fjala për kërkesat periodike aksesore, sikunder është kërkesa e kamatës, ashtu edhe kur është fjala për kërkesën periodike të atilla në të cilat sosit vetëm e drejta sikunder është kërkesa e ushqimit, parashkruhen tre vjet nga rrjedhja e secilës dhënie të veçantë për pagesë”.*

Kurse sipas nenit 360 të njëjtit ligj parashihet se: *“Me parashkrimin pushon e drejta e kërimit të përmbushjes se detyrimit. Parashkrimi lind kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit dhe Gjykata nuk mund të përfillë parashkrimin në qoftë se debitori nuk e ka invokuar atë”.*

Pretendimet lidhur me parashkrimin e kërkesëpadisë.

Për gjatë procedurës e paditura si në përgjigje në padi po ashtu edhe në seancat gjyqësorë pretendimi i saj kryesor ishte së kërkesa e paditësit për kompensim dëmi është e përfshirë në parashkrim, të cilin pretendim gjykata bazuar në dispozitat e lartcekura e ka vlerësuar dhe ka ardhur në përfundim së pretendimi i të paditurës në këtë çështje juridike kontestimore është pjesërisht i bazuar. Gjykata vlerëson se paditësi ka pasur të drejtë të kërkojë kompensimin e dëmit jo material në emër të shëmtimit nga e paditura duke filluar nga data 27.10.2010, ngase me këtë datë është krijuar detyrimi mes palëve përkatësisht koha kur është shkaktuar aksidenti. Kurse paditësi në gjykatë ka parashtruar padi me datë 19.06.2017, përkatësisht, pas 6 viteve. Sipas nenit 361 të LMD-së: *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”.* Neni 377 par. 1 i LMD-së rregullon: *“Kur dëmi është shkaktuar nga vepra penale dhe për ndjekjen penale është parashkruar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblimin e dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale”.* Lidhur me aplikimin e kësaj dispozite në rastin kontestues, gjykata vë në dukje se në rastin konkret nuk mund të zbatohet kjo dispozitë për faktin se procedura penale e zhvilluar ndaj të sigurvearit të palës së paditur ka përfunduar më aktgjykim meritor përkatësisht sipas aktgjykimit penal P.nr.../10, i datës 30.11.2011, i cili aktgjykim gjendet në shkresat e lëndës C.nr.../15. Por sido që të jetë, ka kaluar koha e parashkrimit edhe në kuptim të kësaj dispozite. Sipas nenit 388 të LMD-së:



*“Parashkrimi ndërpritet me ngritjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose organit tjetër kompetent me qëllim përcaktimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”.* Gjykata gjen se paditësi nuk i ka prezantuar gjykatës asnjë provë apo fakt, i cili do të kishte rëndësinë vendimtare të ndërprerjes së afatit të parashkrimit, që rrjedhimisht do të përbënte shkak që koha e kaluar e parashkrimit të mos llogaritet dhe që parashkrimi të ri-fillonte. Pretendimi i palës paditëse se i njëjti kërkesën e tillë e kishte paraqitur sipas padisë fillestare e cila gjendet në shkresat e lëndës C.nr.../5, mirëpo e njëjta nuk ishte vendosur nga ana e gjykatës, një pretendim i tillë është tërësisht i pabazuar ngase nga shkresat e lëndës C.nr.../15 përkatësisht duke filluar nga padia e paditësit dhe aktgjykimet e Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.../15, i datës 06.07.2015 i vërtetuar/ ndryshuar nga Gjykata e Apelit me aktvendim Ac.nr .../2015, i datës 06.12.2016 dhe aktgjykimet të Gjykatës Supreme Rev.nr.../2017, i datës 15.05.2017, rezultojnë se paditësit në asnjë rast nuk ka paraqitur kërkesë për kompensim e dëmit për shëmtim dhe zvogëlim të aftësisë punuese. Gjithashtu gjykata shton se edhe po të merrej parasysh fakti se paditësit ka kuptuar për shkaktimin e dëmit dhe personit nga i cili i është shkaktuar dëmi sipas aktgjykimet penal P.nr.../10, i datës 30.11.2011, gjykata vlerësoi se përsëri që nga aktgjykimi i tillë e deri në momentin e paraqitjes së padisë së paditësit, bazuar në dispozitën e lartcekur në nenin 376 par.1 dhe 2 të LMD-së, ka kaluar koha e parashkrimit.

Gjykata thekson se lidhur me të drejtën për kompensim e dëmit përkatësisht të dëmit jo material në emër të shëmtimit, bazuar në dispozitat ligjore të cekura me lartë, është tejkaluar çdo afati ligjor për paraqitjen e një kërkesë të tillë dhe nga kjo rezultojnë se kërkesëpadija e paditësit për këtë formë të dëmit është e parashkruar.

Po ashtu, pas administrimit dhe vlerësimit të gjitha provave në shkresat e lëndës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadija e paditësit sa i përket kompensimit të dëmit këtu fitimit të humbur-rentës, bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë përkatësisht sipas nenit 372 të LMD-së, ku afati i parashkrimit për këtë kategori të dëmit, duhet llogaritur për secilën kërkesë të arritur veç e veç, pra për secilin muaj veç e veç, pasi që kemi të bëjmë me kërkesë e cila u referohet dhënieve periodike mujore, pra muaj për muaj, me çka kur marrim parasysh faktin se padia në gjykatë nga paditësi del se është ushtruar me datë 19.06.2017, ndërsa shkaktimi i aksidentit ka ndodhur me datën 27.10.2010, vie në përfundim se kërkesat periodike të paditësit të cilat rrjedhin nga periudha nga data e shkaktimit të aksidentit 27.10.2010 e deri në me datën 26.05.2014, duke e llogaritur që secila kërkesë mujore e arritur që nga data e aksidentit e deri në momentin e paraqitjes së paditëse, është e parashkruar.

Sa i përket kërkesëpadiës së paditësit për këtë kategori të dëmit, për periudhën që nga data 27.05.2014 e tutje, bazuar në administrimi dhe vlerësimin e provave përkatësisht nga ekspertiza e përpiluar nga Dr. Qefsere Restelica, eksperte nga mjekësia e punës, e datës 28.08.2023, ku e njëjta ka ardhur në përfundim se paditësi ka zvogëlim të aftësisë punuese në shkallës prej 15% për disa aktivitet punues të caktuara, e njëjta nuk ka konstatuar se zvogëlimi i aktivitetit punues në këtë përqindje tek paditësi të ketë ndikuar në profesionin e tij apo të ndikuar në vendin e tij të punës, e që për gjykatën kjo ekspertize, ishte e qartë e argumentuar dhe të njëjtës i ka falur pjesërisht besimin. Po ashtu bazuar edhe në ekspertizën e përpiluar nga eksperti Aziz Berisha,

ekspert nga lëmia financiare – aktuaristikës, si ajo e datës 23.11.2018 dhe e datës 01.05.2024, gjykata gjeti se eksperti në fjalë përkundër faktit se ka bërë një kalkulim të fitim të humbur për paditësin duke u bazuar në përqindjen e zvogëlimit të aftësisë punuese, i njëjti ka konstatuar se paditësi nga periudha 2010 e deri në ditën e përpilimit të ekspertizës, i njëjti ka punuar dhe ka pranuar pagën mujore, ashtu sipas kontratave me të cilat kishte krijuar marrëdhënie pune. Po ashtu duke u bazuar edhe në kontratën e punës e lidhur ndërmjet subjektit Egi Grup sh.p.k si punëdhënës dhe Q.D., si punëmarrës, me datë 01.11.2010, me numër të protokollit 08/2017, kontratës se punës e lidhur me datë 01.12.2017, ndërmjet subjektit Egi Grup sh.p.k si punëdhënës dhe Q.D., si punëmarrës, pasqyra e llogarisë të trustit pensional për Q.D., për periudhën 16.11.2003-16.11.2018 dhe vërtetimit tatimorë në emër të Q.D., e lëshuar me datë 21.11.2018, gjykata vërtetoi se përkundër faktit se paditësi kishte pësuar lëndimet përkatësisht zvogëlim të aftësisë punuese në shkallë prej 15%, i njëjti ka punuar dhe ka gjeneruar të ardhura mujore, sipas kontratave të lartcekura, ndërsa gjatë periudhës në të cilin kohë pas kohë paditësi nuk ka punuar ashtu siç është konstatuar nga eksperti nga lëmia financiare- aktuaristikës, i njëjti me asnjë provë nuk e ka argumentuar faktin së një gjë e tillë ka ndodhur si pasojë e zvogëlimit të aftësisë punuese. Nga të gjitha të cekurat më lartë dhe bazuar në dispozitën ligjore të nenit 7 par.1 të LPK-së, ku: *“palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa sipas dispozitës së nenit 319 par.1 të LPK, secila palë ndërgjyqës, ka për detyrë ti provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit për këtë kategori të dëmit, duhej të refuzuar në tërësi si e pabazuar, sepse paditësi me asnjë provë nuk ka arritur të bëjë të besueshëm faktin se i njëjti si pasojë e lëndimeve përkatësisht zvogëlimit të aftësisë punues në shkallën prej 15%, të i ketë ndikuar që i njëjti të humb marrëdhënien e punës, të ketë degradim në pozitën e tij në marrëdhënien në punës, apo zvogëlim në pagën mujore si pasojë e lëndimit të tij, përkundrazi nga provat e administruara dhe vlerësuar me lartë të cilave gjykata iu fali besimin, del se paditësit ka punuar dhe ka gjeneruar të ardhura mujore, e që në rastin e tillë del që paditësi nuk ka pësuar fitim të humbur si pasojë e lëndimeve në fjalë.

Gjykata me rastin e vendosjes mori për bazë të gjitha provat e tjera të administruara në shqyrtimin gjyqësor mirë po të njëjta nuk kishin ndikim që të vendoset ndryshe.

Gjykata ka refuzuar propozimin e palës së paditur, që të detyrohet paditësit që i njëjti të i dorëzoj provat përkatësisht kontratat punës, me arsyetimin se të njëjta janë të bashkangjitura në shkresat e lëndës.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të LPK-së përkatësisht në dispozitat ligjore të nenit 449 par.1, 463 par. 1 dhe 2, neni 452 par.2 e lidhur me nenin 450 të po të njëjtit ligj, duke pasur parasysh suksesin e palëve ndërgjyqëse në këtë çështje kontestimore dhe pasi që pala e paditur nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga arsyet e cekura si më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 143 të LPK - së.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**C.nr.2914/21, me datë 26.02.2024**

**Gjyqtarja,**  
Rajmonda Kurteshi

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi, nëpërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.